



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 31

Datë: 23. 11. 2023. Ora: 13:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Alban Krasniqi, Arianit Elshani, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Mufera Shinik, Čemailj Kurtiš, Fazli Stollaj.

RENDI I DITËS

- 1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së**
- 2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së KQZ-së Nr.30/2023**
- 3. Raportet e Këshillave të KQZ-së**

3.1.Këshilli për Buxhet dhe Financa

1. Shqyrtimi dhe miratimi i Plan - Buxhetit për projektin për punëtorinë "Hartimi i planit të punës së KQZ 2024".

2. Shqyrtimi dhe miratimi i marrëveshjes së bashkëpunimit më kompozitorët

4.2.Këshilli për Operacione Zgjedhore

1. Shqyrtimi dhe miratimi i Projektit dhe agjendës: Takim pune për hartimin e Planit të Punës të KQZ-së për vitin 2024,

2. Shqyrtimi dhe miratimi i formës së kërkesës për Kryetarët e Komunave,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i produkteve dhe media planeve për fushatën e IP-së për identifikimin dhe ndërrimin e QV-së,

5.3.Këshilli për Marëdhënie me Jashtë

1.Shqyrtimi dhe miratimi i Ftesës nga A-WEB për të marrë pjesënë ngjarjen online e organizuar nga Komisioni Zgjedhor i Afrikës së Jugut

2.Shqyrtimi dhe miratimi i anëtarësimit të KQZ-së në organizatën WEM

6. Të ndryshme !

1. Hyrje: z.Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

Kryetari Radoniqi, pasi që paraqiti agjendën e mbledhjes pyeti anëtarët nëse ka dikush me shtue diçka, me propozua etj. Arianit Elshani pyeti nëse ka ndonjë njoftim nga zyra e Partive Politike se a është përcjellë një “konventë” e mbajtur e një subjekti politik gjatë këtij muaji ? Dhe, lidhur me “kandidaturat e kandidatëve që duhej t’ishin” meqë, kemi parë deklarime publike...! Besnik Buzhala tha se, zyra nuk ka përgatitur ndonjë informacion ose njoftim, apo raport...

Me 9 vota për, u miratua agjenda e mbledhjes.

Në vazhdim, anëtarët e KQZ-së shqyrtuan procesverbalin nr. 30. Kryetari Radoniqi tha se z. Kurteshi ka bërë disa vërejtje në tekst, a pajtoheni...? Në kontekst, me 9 vota për u miratua procesverbalin nr. 30/2023 nga mbledhja e fundit e KQZ.

2. Raportet e Këshillave të KQZ-së

Këshilli për Buxhet dhe Financa

Shqyrtimi dhe miratimi i Plan - Buxhetit për projektin për punëtorinë "Hartimi i planit të punës së KQZ 2024":

Gordana Llaban, tha se “sot e kemi mbajtur takimin e këshillit dhe se, është shqyrtuar buxheti lidhur me planifikimin e mbajtjes së një punëtorie ku do të bëhet hartimi i planit të punës së KQZ –së për vitin 2024. Dhe pika tjetër, ajo e miratimit të “marrëveshjes së bashkëpunimit më kompozitorët”! KQZ, mendon ta organizojë punëtorinë jashtë vendit, me këtë rend. Është planifikuar që punëtorja të mbahet nga data 7-10 dhjetor, dhe do të marrin pjesë 25 zyrtarë. Shpenzimet i mbulon KQZ-ja. 13.605 euro. Ne, e kemi shqyrtuar, dhe buxhet ka, prandaj rekomandojmë të mbahet...

Me 10 vota për, ky rekomandim u miratua.

Pika tjetër, ashtu sipas planifikimit KQZ do ti shpërblejë të tre kandidatët pjesëmarrës, dhe ne rekomandojmë që “marrëveshjet të nënshkruhen” dhe sipas planit, të bëhet pagesa. Këtu nuk ka se çka të votohet...

3. Këshilli për Operacione Zgjedhore

Shqyrtimi dhe miratimi i Projektit dhe agjendës: Takim pune për hartimin e Planit të Punës të KQZ-së për vitin 2024:

Alban Krasniqi tha se, pikë e rendit të takimit të këshillit ka qenë shqyrtimi i agjendës së hartimit të planit të punës, u tha aspekti buxhetorë kurse në takim, janë dhënë disa sugjerime nga aspekti i agjendës: metodologjia e punës që do aplikohet. Në parim, ne mund ta aprovojmë por të shohim inkorporimin në agjendë.

Kreshnik Radoniqi: E keni lënë datë të 7-in, e nëse ne udhëtojmë rreth 300 kilometra, dhe ne fillojmë menjëherë, a është llogaritur kjo...? E dyta, ka aspekte teknike, pastaj çështja e akomodimit etj. Nuk po kundërshtoj por, më vështirë menaxhohet...

Arianit Elshani: Kemi rënë dakord me këtë agjendë, e kemi votue të gjithë në këtë format. E kuptoj shqetësimin, por janë prezantime, dhe dita e parë është vetëm “prezantim” ndërsa dita e dytë dhe e tretë, janë me shqyrtime – analiza...

Në këtë pikë, diskutuan edhe: Gordana Llaban, Alban Krasniqi, Kreshnik Radoniqi.

Me 10 vota për, miratohet agjenda për punëtorinë.

Shqyrtimi dhe miratimi i formës së kërkesës për Kryetarët e Komunave:

Arianit Elshani, tha se ne e kemi shqyrtuar këtë pikë të rendit: takimet me kryetarët e komunave dhe për ti informuar ata ndryshimin e ligjit për zgjedhjet, obligimet apo përgjegjësitë që marrin komunat për mbështetjen e tyre për KKZ-të. Ky aktivitet, mendojmë të fillojë nga 15 janari 2024. Shkresat, informacionet, komunikimet dhe çështjet e tjera të përgatiten, ashtu si edhe organizimi i grupeve – formatit i tyre etj. Rekomandojmë që kjo pikë të miratohet...

Alban Krasniqi, tha se afati – koha tani nuk është e favorshme për të filluar takimet për shumë arsye, se është fundi i vitit, se edhe sekretariati ka nevojë të përgatitet më mirë... Shkresa mund të aprovohet, por është një mori çështjesh të tjera që kërkojnë angazhim, përgatitje të dhënash etj.

Çemal Kurti, tha se mendoj që duhet të reagojmë qysh tani me komunikime përmes zyrtarëve tanë: si, cilat janë problemet, cilat kanë përparësi më shumë, dhe qysh tash të mos mbesim në zero por, të shohim qysh tani se cilat janë problematikat...Të fillojmë të mobilizohemi...

Sami Hamiti, tha se raporti duhet të kompletohet prandaj se kemi këtu. Kishte edhe çështje të objekteve, qendrat e votimit dhe të kemi një raport më të qartë...Pra, edhe partnerët tanë mund të jenë më të lirë në fillim të vitit...

Arianit Elshani, tha se ne edhe më herët e kemi shqyrtua këtë çështje dhe se, megjithatë kemi mendue se, koha është më optimale në fillim të vitit. Rekomandojmë që si “plan – projekt” të miratohet, në parim, në mënyrë që ne të startojmë operacionalisht në fillim të vitit tjetër...

Me 10 vota për, miratohet “Forma e kërkesës për Kryetarët e Komunave”, dhe data e fillimit të projektit “15 janar, 2024” (mbi bazën e takimit - mbledhjes nr. 29/2023).

Shqyrtimi dhe miratimi i produkteve dhe media planeve për fushatën e IP-së për identifikimin dhe ndërrimin e QV-së:

Arianit Elshani tha se, KOZ ka shqyrtuar dhe miratuar produktet dhe media planet për fushatën e informimit publik për identifikimin dhe ndërrimin e Qendrave të Votimit. Sot, përmes kësaj “platforme” unë ju informoj se KQZ për herë të parë lanson një fushatë të këtillë. Kjo, është bërë edhe në relacion me ndryshimin e ligjit për zgjedhjet. Pra, janë një seri produktesh që do të publikohen. Rekomandojmë që këto produkte, të miratohen...

Në vazhdim, anëtarët e KQZ –së miratuan produktet dhe media planin e IP-së për identifikimin dhe ndërrim e QV-e.

4. Këshilli për Marrëdhënie me Jashtë

Shqyrtimi dhe miratimi i anëtarësimit të KQZ-së në organizatën WEM:

Kreshnik Radoniqi: Janë dy kërkesa që i kemi shqyrtuar në takimin e fundit të këshillit, nuk kemi marrë ndonjë vendim, por e kemi lënë që të diskutojmë në mbledhje të KQZ.

Po shkojmë me pikën e dytë, “anëtarësimit të KQZ-së në organizatën WEM”. Kjo, është si vazhdimësi, kur unë isha në Pragë. Atje, kanë shprehur interesim disa shtete për tu anëtarësuar. Shtetet e rajonit nuk janë, ka mbetur me u diskutue...Pra, ka mbetur që unë të diskutoj me kryetarët e KQZ-ve të rajonit. Shqipëria, ka interesim...! Mali i Zi, nuk do të anëtarësohet...

E diskutuam në këshill, por nuk kishim fort interesim. Shuma është diku mes 2000 – 3000 euro! Ende nuk është e saktësuar. Më shumë fokusi i kësaj organizate është fuqizimi i grave në menaxhim, kapacitetet, rrjetëzimi global, barazia gjinore, fuqizimi i tyre në menaxhim, njoha ndërkombëtare...

Ilir Gashi tha se, “nuk e dimë kush janë anëtarët komplet, nuk ka informacion kush janë...! Pa dashtë me injorur asnjë shtet, nuk po më duket se kjo organizatë ka shtete serioze, janë ish shtete të ish bllokut sovjetikë...

Se dimë kush është...! Janë do probleme që mua më bëjnë skeptik. Kemi pasur rast kur kemi qenë anëtarë, kemi pasur ftesë por, s’kemi mundur të shkojmë për shkak të procedurave, çështjet e njohjes...

Në këtë pikë, diskutuan: Arianit Elshani, kërkoi të ketë më shumë informata, nuk jam kundër por nuk jam as për sot...! Alban Krasniqi, tha se do duhej dikush të merrej me një analizë, e le të na njoftojë...!

Kreshnik Radoniqi, tha se afati i aplikimit është deri më 1 dhjetor...Në rregull, le të mbetet pa vendim sot dhe e trajtojmë edhe njëherë...

Pika e dytë: është një ftesë nga A-WEB për të marrë pjesë në ngjarjen online e organizuar nga Komisioni Zgjedhor i Afrikës së Jugut.

Lidhur me këtë pikë, referoi krye shefi Ahmetaj. Ai tha se ftesa është pranuar, dhe tema e diskutimeve është: “Mbrojtja e organeve të menaxhimit të zgjedhjeve në epokën e recesionit demokratikë”. Data dhe ora e kësaj ngjarje është 30 nëntori: ora 9:00. Në mbrëmje. Të interesuarit, duhet të regjistrohen...

Kreshnik Radoniqi: Mund të marrin pjesë nga sekretariati, ti Burim, Kreshniku, Premtimi...

7. Të ndryshme !

Kreshnik Radoniqi: Ju them se, ndoshta duhet një mbledhje para se të nisemi për Tiranë, sepse e kemi një afat për regjistrim të një partie të re...

Në vazhdim, në të ndryshme u diskutua lidhur me lansimin e fushatës së IP-së, hapja e fushatës...etj.